

Mundësi për aplikim për bashkitë në thirrjen “INSPIRE Open Call për Autoritetet Lokale dhe Rajonale në Rajonet e Asociuara”

Synimi i thirrjes:

INSPIRE ka për qëllim nxitjen e përdorimit të teknologjive dhe veprimeve për zbulimin, mbledhjen dhe parandalimin e mbetjeve (koncepti DCP), duke përfshirë makro dhe mikroplastikat, në lumenjtë europianë. Kjo thirrje synon përzgjedhjen e propozimeve që do të mbështesin zgjerimin, replikimin dhe shfrytëzimin e përvojave dhe mësimave të nxjerra nga rastet e suksesshme të projektit INSPIRE.

Kush mund të aplikojë:

Të drejtën për të aplikuar e kanë autoritetet lokale dhe rajonale nga **Shtetet Anëtare të BE-së ose vendet e asociuara me Horizon Europe, ku bën pjesë edhe Shqipëria**. Propozimet duhet të vijnë nga **autoritete publike** që mbikëqyrin dhe rregullojnë mirëqenien publike në **nivel lokal** ose **në nivel qarku**, si bashkitë apo qarqet. Universitetet dhe kompanitë private nuk janë të pranueshme për financim direkt, por mund të marrin pjesë si nën-kontraktorë.

Fushat dhe llojet e aktiviteteve:

Projektet duhet të përfshijnë aktivitete që synojnë zbulimin, mbledhjen dhe parandalimin e mbetjeve në lumenj, duke kontribuar në një nga aspektet e mëposhtme: përmirësimin e metodave të zbulimit të ndotjes, krijimin e strategjive për mbledhjen e mbetjeve, dhe zbatimin e masave për parandalimin e ndotjes. Këto aktivitete duhet të ndihmojnë në përmirësimin e cilësisë së mjedisit dhe të përfitojnë nga mësimet e rasteve ekzistuese të projektit.

Buxheti i thirrjes:

Buxheti total i thirrjes për INSPIRE është **500,000 EUR**. Çdo projekt mund të aplikojë për një financim nga **60,000 EUR** deri në **100,000 EUR**, në varësi të nevojave dhe qëllimeve të projektit.

Si bëhet aplikimi:

Aplikimet duhet të dorëzohen elektronikisht përmes Google Forms ose TypeForm, duke përfshirë dokumentet e nevojshme si template i aplikimit dhe buxheti që gjenden në faqen e thirrjes. Afati për dorëzim është **deri më 29 nëntor 2024, në orën 17:00 (ora e Brukselit)**.

Linku i thirrjes:

https://inspire-europe.org/open-call/?utm_content=301663905&utm_medium=social&utm_source=twitter&hss_channel=tw-127882073266797728